



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument
parlamentar

Tiranë më 14 .05.
2019

RAPORT

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKËS (INSTAT)
PËR VITIN 2018

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 14.05.2019, zhvilloi seancën dëgjimore për veprimtarinë e INSTAT, për vitin 2018. Kjo seancë dëgjimore u bë bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, nenin 13, gërma “d”, të Ligjit të ri nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

Në mbledhjen e komisionit ishte e pranishme Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT Znj. Delina Ibrahimaj dhe përfaqësues të tjerë të Institucionit. Znj. Ibrahimaj paraqiti drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit të mëparshëm si dhe prioritetet për vitin 2019.

II. Performanca e Institucionit

Miratimi në prill të vitit 2018 i ligjit të ri nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, ishte një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me standardet europiane. Përparësitë që solli ligji i ri ishin forcimi i pavarësisë profesionale të INSTAT, forcimi i rolit udhëheqës të INSTAT në prodhimin e statistikave zyrtare, forcimi i mandatit të prodhuesve statistikorë për të drejtën e hyrjes në të dhënat administrative, si dhe zgjerimi i autonomisë së INSTAT për administrimin dhe përdorimin e burimeve të veta.

Gjatë vitit 2018 INSTAT u fokusua në fillimin e punëve përgatitore për Censin e ardhshëm të Popullsisë e Banesave. Për këtë qëllim, u përgatit Strategjia e Censit e cila përcakton bazën ligjore,

teknologjinë që do të përdoret si dhe aspekte operacionale e financiare të Censit 2020, drafti final i pyetësorit të Censit pas konsultimit të pëmbatjes së tij me grupet e interesit si dhe u përgatit projektligji për Censin e Popullsisë dhe Banesave.

Në zbatim të strategjisë së trajnimeve INSTAT është angazhuar në ngritjen e Qendrës së Trajnimit Statistikor në bashkëpunim me ASPA.

Referuar progres raportit 2018, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave. Është bërë progres në shumë fusha statistikore. Persa i përket infrastrukturës statistikore, kuadri ligjor është pjesërisht në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. INSTAT ka përmirësuar gamën dhe cilësinë e statistikave që publikon.

Në qershor 2018 u krye vlerësimi i funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor (Peer Review), nga ekspertë vlerësues të Eurostat. Ky është procesi i tretë i këtij lloji që zhvillohet në vendin tonë. Në përgjithësi, ekspertet vlerësuan se Sistemi Kombëtar Statistikor i Shqipërisë është në masë të madhe në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane dhe rekomandimet në raport kanë për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të pajtueshmërisë.

III. Diskutimi në komision

Relatori, i caktuar nga Komisioni për këtë çështje Znj. Blerina Gjylameti, paraqiti një relacion me vlerësimet e saj për veprimtarinë njëvjeçare të këtij institucioni si dhe disa rekomandime për përmirësimin e punës gjatë vitit në vazhdim. Më pas Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT Znj. Delina Ibrahimaj, iu përgjigj pyetjeve të disa prej deputetëve të pranishëm.

Kryetari i Komisionit të Ekonomisë Z. Arben Ahmetaj shprehu qëndrimin e tij duke theksuar se publikimet e INSTAT duhet të detajohen dhe interpretohen sa më qartë, që të jenë sa më të kuptueshme për publikun e gjerë dhe sa më në ndihmë të politikbërësve. Bashkëpunimi më i ngushtë me median do ishte një ndihmë në këtë drejtim.

IV. Përfundime

Komisioni miratoi, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, projektrezolutën për veprimtarinë e Institutit të Statistikës për vitin 2018, në të cilën pasqyroi vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse. Këtë projektrezolutë, sipas variantit bashkëlidhur, Komisioni ia paraqet seancës plenare për votim.

RELATOR

Blerina GJYLAMETI

KRYETAR

ARBEN AHMETAJ